



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Republikës së Kosovës do të përfaqësohet me këtë ekip negociator:
 - 1.1. Fatmir LIMAJ - Kryesues;
 - 1.2. Enver HOXHAIJ - Zëvendëskryesues;
 - 1.3. Behxhet PACOLLI - anëtar;
 - 1.4. Dardan GASHI - anëtar;
 - 1.5. Mahir YAGCILAR - anëtar;
 - 1.6. Avni ARIFI - anëtar.
2. Po ashtu në këtë ekip rezervohen vendet për përfaqësuesit e opozitës:
 - 2.1. Përfaqësues nga LDK;
 - 2.2. Përfaqësues nga VV;
 - 2.3. Përfaqësues nga PSD;
 - 2.4. Përfaqësues nga Alternativa;
 - 2.5. Ekspert nga Shoqëria Civile.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit për aprovim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë